



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 443/4 Prot.

Tiranë, më 06.07.2018

V E N D I M

Nr.71, datë 06.07.2018

**MBI PËRFUNDIMIN E VERIFIKIMIT TË INFORMACIONIT TË MARRË
NËPËRMJET KËRKESËS SË APLIKANTES ***** , PROTOKOLLUAR ME NR.
443 PROT., DATË 14.05.2018**

Në mbështetje të kompetencave ligjore, të parashikuara në pikën 1, tënenit 11 dhe nenet 14 e 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në përfundim të procedurës së verifikimit,

VËREJ SE :

Me anën e kërkesës/informacionit të regjistruar pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil me nr.443 prot., datë 14.05.2018, kandidatja ***** , ka ngritur pretendimin se, faza e dytë e konkurrimit, pra ajo e intervistës së strukturuar me gojë, për pozicionin “Specialist personeli, në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore”, në Bashkinë Vlorë; Lloji i diplomës “Shkenca Juridike” dhe “Shkenca Ekonomike”, niveli minimal i diplomës “Master profesional”, nuk është zhvilluar në përputhje me kërkesat e ligjit, e për këtë ka renditur disa shkelje të elementëve proceduralë , nga ana e Komisionit të Përhershëm të Pranimi dhe Njesisë Përgjegjëse të Bashkisë Vlorë, ndër të cilët:

- Gjatë intervistës së strukturuar me gojë, nuk është zbatuar pika 5 dhe 6, e Kreut III/7, “Pranimi në shërbimin civil” të Udhëzimit nr. 02, datë 27.03.2015 të Departamentit të Administratës Publike “Për procesin e Plotësimit të Vendeve të Lira të Shërbimin Civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit

të hapur”, ku parashikohet mundësia e regjistrimit të intervistës së strukturuar me gojë se, në rastin kur e kërkon kandidati. Ankuesi pretendon se, nga ana e subjektit përgjegjës që ka realizuar këtë fazë të rekrutimit, nuk është zbatuar kjo procedurë, çka provohet me faktin se intervista nuk është regjistruar dhe nuk ka asnjë deklaratë të nënshkruar që të vërtetojë që kandidatja nuk e ka kërkuar regjistrimin e procesit.

- Nuk është respektuar transparenca e procesit dhe barazia e palëve, pasi kandidatja pretendon se nuk është njoftuar për rezultatin e testimit në asnjë nga format e parashikuara nga ligji, si konkurrenca me të drejta procedurale të barabarta në proces, në kundërshtim me pikën 15, të Kreut IV, të Vendimit, nr. 243, datë 18.03.2015 të Këshillit të Ministrave *“Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimi në kategorinë ekzekutive”*.

Duke qenë se shkak i kryesor i shkeljeve procedurale të lartpërmendura ka ardhur nga mosveprimi administrativ i Komisionit të Përhershëm të Pranimit dhe njësisë përgjegjëse (*Drejtorisë së Burimeve Njerëzore*), të Bashkisë Vlorë, kandidatja ka kërkuar ndërhyrjen e Komisionerit përshpalljen e pavlefshme të procedurës së konkurrimit për pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive, në pozicionin *“Specialist personeli, në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore”*, në Bashkinë Vlorë; Lloji i diplomës *“Shkenca Juridike” dhe “Shkenca Ekonomike”*, niveli minimal i diplomës *“Master profesional”*.

Pas kryerjes së verifikimit paraprak të këtij rasti, rezultoi se Bashkia Vlorë, në zbatim të nenit 22 dhe të nenit 25, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, si dhe të Kreut II, IV dhe VI, të Vendimit nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave *“Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”*, nëpërmjet shkresës nr. 2238, datë 20.03.2018, *“Kërkesë për shpallje në Portalin e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”*, në institucionin e Shërbimit Kombëtar të Punësimit, ka dërguar njoftimin për shpalljen e procedurës së pranimit, për grupin e pozicioneve në llojin e diplomës *“Shkenca Juridike” dhe “Shkenca Ekonomike”*, niveli minimal i diplomës *“Master profesional”*, për pozicionin *“Specialist personeli, në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore”*, në Bashkinë Vlorë.

Nga përmbajtja e njoftimit rezulton se pozicioni në fjalë, i është ofruar fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele. Në përfundim të afatit të përcaktuar (data 02.04.2018), duke qenë se nuk është paraqitur asnjë aplikant për procedurën e lëvizjes paralele, është kaluar në procedurën e pranimit në shërbimin civil. Njësia Përgjegjëse (*Drejtorisë së Burimeve Njerëzore*) e Bashkisë Vlorë, pasi ka kryer verifikimin paraprak të kandidaturave të paraqitura, në lidhje me plotësimin e kërkesave të përgjithshme dhe të veçanta të përcaktuara në shpalljen për konkurrim, nëpërmjet shkresës nr. 2238/1, datë 13.04.2018, ka dërguar pranë institucionit të Shërbimit Kombëtar të Punësimit, kërkesën për shpallje në Portalin e këtij të institucioni të listës me emrat përkatës të kandidatëve të kualifikuar dhe më tej, me shkresën nr. 2238/2, datë 18.04.2018, *“Kërkesë për shpallje në Portalin e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”*, ka dërguar listën përfundimtare me kandidatët e kualifikuar për të vazhduar

konkurrimin dhe datën e testimit. Nga përmbajtja e këtyre kërkesave, rezulton se aplikantët ***** , ***** dhe ***** , janë kualifikuar për të vijuar procesin e konkurrimin në fazat e tjera të tij

Po kështu, rezulton se, në zbatim të pikës 5, të Kreut VI, të Vendimit nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, kandidatët që nuk plotësonin kërkesat e përcaktuara në shpalljen për konkurrim, janë renditur në një listë të veçantë dhe janë njoftuar individualisht për këtë fakt, nga Njësia Përgjegjëse (Drejtoria e Burimeve Njerëzore) e Bashkisë Vlorë ((*materialet janë të administruara dhe gjenden në dosjen e përkatëse, pranë Komisionerit*).

Konstatohet se, procedura e konkurrimin është zhvilluar në datën 20.04.2018, në orën 11.00, në ambientet e Bashkisë Vlorë (*procesverbali i datës 20.04.2018, i mbajtur nga KPP-ja në lidhje me pjesëmarrjen e kandidatëve në testimin me shkrim*) dhe është drejtuar nga Komisioni i Përhershëm i Pranimit (*i ngritur me aktin nr. 3020 prot., datë 19.04.2018, Urdhër i Brendshëm nr. 80 datë 19.04.2018*). Pas përfundimit të testimit me shkrim është zhvilluar edhe intervista e strukturuar me gojë.

Në përfundim të gjithë procesit të mësipërm, Komisioni i Përhershëm i Pranimit, ka përpiluar raportin e datës 20.04.2018 “Struktura e ndarjes së pikëve dhe vlerësimi i kandidatëve konkurrues për pozicionin “Specialist personeli, në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, Bashkia Vlorë”, në të cilin janë llogaritur e shpallur pikët për secilin konkurrent, si për testimin me shkrim, ashtu dhe për intervistën e strukturuar me gojë. Sipas këtij raporti, rezulton se konkurrentja ***** është vlerësuar me 84 pikë, konkurrentja ***** me 67 pikë, ndërsa konkurrentja tjetër, ***** , me 59 pikë, në total.

Nga analiza e materialeve të administruara, në lidhje me dosjen e konkurrimin, si dhe duke marrë shkas nga pretendimi kryesor i konkurrentes, konstatohet se në procedurën e ndjekur nga Komisioni i Përhershëm i Pranimit evidentohen disa mangësi të karakterit procedural, të cilat janë trajtuar në vijim:

- ✓ Nuk është respektuar pika 5 dhe 6, e Kreut III/7 “Pranimi në shërbimin civil” të Udhëzimit nr. 2, datë 27.03.2015 të Departamentit të Administratës Publike, “Për procesin e Plotësimit të Vendeve të Lira të Shërbimin Civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimin të hapur”, ku parashikohet që kandidati informohet për të drejtën që ka për të regjistruar intervistën e strukturuar me gojë. Sipas rregullimeve ligjore, për të materializuar këtë moment procedural, kërkohet që konkurrenti të nënshkruajë një deklaratë ku të pasqyrohet vullneti i tij në lidhje me këtë aspekt ligjor. Kjo kërkesë rezulton të mos jetë respektuar në

këtë rast, ç`ka provohet me faktin se në aktet që materializojnë procesin e rekrutimit, mungojnë deklaratat e nënshkruara nga pjesëmarrësit në konkurrim, duke i vënë në këtë mënyrë, konkurrentët në pamundësi të marrin një përgjigje bindëse, nëse ngrihen pretendime prej tyre, për vlerësime jo të sakta apo parregullsi të tjera. Për më tepër, në këtë rast bëhet i pamundur edhe verifikimi i pretendimit të ankueses *****, se në momentin e kryerjes së intervistës, nuk ishin të pranishëm gjithë anëtarët e KKP-së, ç`ka ndikon në vlerësimin e saktë e objektiv të konkurrentëve.

- ✓ Gjithashtu, rezulton se, në kundërshtim me detyrimin e parashikuar prej pikës 10, të Vendimit nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave “*Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive*”, ku parashikohet se ditën e intervistës së strukturuar me gojë, zgjidhet një grup pyetjesh, i njëjtë për të gjithë kandidatët, Komisioni i Përhershëm i Pranimit nuk e ka hartuar këtë listë pyetjesh dhe nuk e ka depozituar atë në dosjen e testimit, ç`ka komprometon procesin dhe nuk të krijon bindjen, se nga ana e këtij mekanizmi është bërë një vlerësim i paanshëm dhe objektiv, për gjithë konkurrentët.
- ✓ Në pikën 12, të Vendimit nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave “*Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive*”, parashikohet se, Komisioni i Përhershëm i Pranimit, në përfundim të fazës së vlerësimit përfundimtar të kandidatëve, liston kandidatët fitues me mbi 70 pikë (*mbi 70% të pikëve*), duke filluar nga kandidati me rezultatin më të lartë. Kjo listë, i dërgohet njësisë përgjegjëse, **brenda 24 orëve** nga përpilimi i saj, veprim i cili nuk është kryer dhe nuk është dokumentuar siç duhet e në kohën e duhur (*ky akt mungonte në dosjen e konkurrimit*), duke sjellë si pasojë pamundësinë e llogaritjes me saktësi të afateve për procedurat e mëtejshme, përfshirë edhe ato të ankimit ndaj procesit të vlerësimit.

Duke vazhduar më tej analizën, si dhe duke trajtuar edhe pretendimin e dytë të kërkueses, që ka të bëjë me procedurën e njoftimit, njësisë përgjegjëse e Bashkisë Vlorë, në kundërshtim me pikën 15, të vendimit të mësipërm, nuk i ka njoftuar individualisht konkurrentët ***** dhe ***** , që kishin marrë më pak se 70 pikë (*pa e bërë publik këtë fakt*), duke i mohuar në këtë mënyrë atyre, të drejtën e ankimit për rezultatin, që i siguron pika 22, e Kreut IV, të Vendimit nr. 243 datë 18.03.2015 të Këshillit të Ministrave “*Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimi në kategorinë ekzekutive*”, e cila parashikon shprehimisht: “*Kandidati, pavarësisht nga e drejta për t’u ankuar në gjykatën administrative, ka të drejtë të bëjë ankim me shkrim edhe në Komisionin e Përhershëm të Pranimit, për rezultatin e pikëve dhe renditjen në listën fituese, brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual të rezultateve të vlerësimit. Ankuesi merr përgjigje brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga data e përfundimit të afatit ankimor. Në përfundim të këtij afati njësisë përgjegjëse publikon listën përfundimtare të fituesve”.*

Nga ana tjetër, Njësia Përgjegjëse e Bashkisë Vlorë, duke mos respektuar afatet e mësipërme e ka konsideruar të përfunduar procesin e konkurrimit dhe ka shpallur si fitues në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, me aktin nr. 2238/2, datë 28.04.2018 “Kërkesë për shpallje në portalin Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, konkurrenten *****e cila është vlerësuar me 84 pikë.

Më tej, njësia përgjegjëse e Bashkisë Vlorë, me aktin nr. 3 (3494 prot.) datë 07.05.2018 “Akt emërimi”, ka emëruar konkurrenten ***** si “nëpunës civil në periudhë prove”, në pozicionin “Specialist personeli, në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore”, në Bashkinë Vlorë.

Nisur nga gjithë sa u analizua më sipër, arrihet në përfundimin se në këtë konkurrim janë lejuar e kryer një sërë parregullsish, të cilat në kuptimin e të drejtës administrative kualifikohen nën 109"Paligjshmëria e aktit administrativ", të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të RSH”, germab), ku parashikohet se, "Një akt administrativ është i paligjshëm nëse:... "është rezultat i shkeljes të dispozitave lidhur me procedurën administrative";

Konkretisht, pamundësia për të verifikuar pretendimin e konkurrentes ***** se përbërja e Komisionit të Përhershëm të Pranimit, nuk ka qenë e plotë në momentin e zhvillimit të intervistës së strukturuar me gojë, pikërisht për shkak të mungesës së regjistrimit audio të saj dhe mungesës së deklaratës së konkurrentes se nuk e ka dëshiruar regjistrimin, përbën një moment paligjshmërie, i cili cenon parimin e transparencës dhe barazisë së konkurrentëve.

Elementë të tjerë paligjshmërie, janë edhe pamundësia e ushtrimit të së drejtës së ankimit e konkurrentes ***** ndaj rezultateve të konkurrimit, në Komisionin e Përhershëm të Pranimit, për shkak të mungesës së njoftimit individual të saj (pa u bërë publik rezultatet) dhe shpalljes së fituesit të konkurrimit, pa pritur kalimin e afateve dhe ushtrimin e të drejtës së konkurrentëve për tu ankuar para organeve kompetente.

Nga tërësia e asaj ç`ka u analizua më sipër, Komisioneri vlerëson se shkeljet e mësipërme nuk janë të asaj natyre që mund të pasjellin pavlefshmërinë absolute të gjithë procesit të konkurrimit, por nga ana tjetër, këto shkelje cenojnë parimet e konkurrimit të hapur në shërbimin civil, e si të tilla vijnë në kundërshtim me ligjin dhe nuk duhet të lejohen të zhvlerësojnë rëndësinë e konkurrimit, si mjeti më i rëndësishëm për krijimin e një shërbimi civil të qëndrueshëm e cilësor.

Nga renditja e shkeljeve në mënyrë kronologjike, rezultojnë që ato të jenë kryer kryesisht, në fazën e intervistës së strukturuar me gojë e në vazhdim, prandaj për rregullimin e ligjshmërisë së procesit, duhet të ndërhyhet pikërisht, në këtë fazë, duke e përsëritur atë.

Për të realizuar me sukses përsëritjen e kësaj faze të konkurrimit, në zbatim të nenit 114, të Kodit të Procedurave Administrative, njësia përgjegjëse duhet të fillojë procedurën e rivendosjes së ligjshmërisë anulimin e aktit të emërimit për nëpunësen ***** dhe më tej, të orientojë Komisionin e Përhershëm të Pranimit, për të përsëritur procedurën e intervistës së strukturuar me gojë.

Për këto arsye:

Bazuar në nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, në ligjin nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” e nenin 35, të Rregullores, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Të rregullohet ligjshmëria në administrimin e shërbimit civil nga ana e njësisë përgjegjëse në Bashkinë Vlorë, duke anuluar aktin e emërimit nr. 3 (3494 prot.) datë 07.05.2018 “Akt emërimi si nëpunës civil në periudhë prove”, të punonjësës ***** , në pozicionin “Specialist personeli, në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore”, në Bashkinë Vlorë.
2. Komisioni i Përhershëm i Pranimit, i ngritur për të plotësuar pozicionin e punës objekt shqyrtimi, të përsërisë procedurën e intervistës së strukturuar me gojë, duke pasur parasysh kërkesat e Vendimit nr. 243 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimi në kategorinë ekzekutive” dhe Udhëzimit nr. 02 datë 27.03.2015 të Departamentit të Administratës Publike, sidomos në momentin e informimit të kandidatëve për të drejtën e regjistrimit të intervistës së strukturuar me gojë, si dhe në lidhje me vijimësinë e procesit në fazat përkatëse të tij.
3. Komisioni i Përhershëm i Pranimit, pasi të kenë kaluar afatet e ankimit si dhe pasi të jenë ezauruar të drejtat e ankimit të pjesëmarrësve në konkurrim, të njoftojë njësinë përgjegjëse në Bashkinë Vlorë, për rezultatin e fituesit, për të mundësuar vijimin e procesit me procedurat e mëtejshme.
4. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat **10** ditë nga marrja dijeni për këtë vendim.
5. Me kalimin e këtij afati, njësia e vetëqeverisjes vendore, Bashkia Vlorë, duhet të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi, duke paraqitur të gjitha aktet administrative që vërtetojnë masat e marra.

6. Njësia përgjegjëse e institucionit, të njoftojë të gjithë punonjësit e përfshirë në këtë proces dhe që janë ngarkuar me detyra specifike në vendimin e Komisionerit, pasi në përfundim të afatit të paralajmërimit, në rast se nuk janë marrë masa për rregullimin e ligjshmërisë, përgjegjësia disiplinore dhe ligjore do të jetë individuale për nëpunësin që nuk ka vepruar në përputhje me ligjin.
7. Të njoftohen për këtë vendim Bashkia Vlorë, njësia përgjegjëse e këtij institucioni dhe kandidatja *****.
8. Në rast të moszbatimit të këtij vendimi, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e ligjshmërisë, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, duke përdorur mjetet ligjore për të rivendosur ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjobitjes së nëpunësit përgjegjës për mos zbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha